



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 9 tetor 2019

Z. Bahri Hyseni, Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Rr. "Luan Haradinaj". nr. 16/1
Zona II. Kategoria II

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 448 / 2019

OJQ "ADMOVERE"

kundër

Këshillit Prokurorial të Kosovës

I nderuari z. Hyseni,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike,¹ më 23 maj 2019, ka pranuar ankesë nga znj. Rina Kika, në cilësinë e përfaqësueses së autorizuar të organizatës joqeveritare "ADMOVERE", parashtruar kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).

Sipas informacioneve të ofruara kuptohet që OJQ "ADMOVERE" është duke punuar në përpilimin e raportit "Profesorët Përball Ligjit", i cili ka për qëllim të nxjerrë të dhëna për atë se si administrohen rastet nga sistemi i drejtësisë, kur të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar janë profesorët e Universitetit të Prishtinës. Po ashtu, qëllimi i raportit është që të mblidhen të dhëna se a ndërmerren masa ndaj stafit akademik për shkelje të Kodit të Etikës së UP-së. Më 14 shkurt 2019, OJQ "ADMOVERE" ka realizuar takim me përfaqësuesit e KPK-së lidhur me projektin dhe qasjen në të dhënat e nevojshme, me ç' rast KPK-ja ka premtuar se do të angazhohet për sigurimin e të dhënave të kërkuara në këtë takim. Lidhur me këtë çështje, OJQ "ADMOVERE", më 21 shkurt 2019, përmes postës elektronike, i është drejtuar KPK-së me kërkesë për qasje në dokumente publike/të dhëna statistikore për secilin vit, që nga paslufta, për stafin akademik të UP-së. Megjithatë, deri në ditën kur ka paraqitur ankesë në IAP, OJQ "ADMOVERE" nuk ka marrë përgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

Më 18 qershor 2019, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë KPK-së, duke kërkuar

¹ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2019, ndërsa kërkesa e drejtuar nga ankuesi është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri

informacione për veprimet që i ka ndërmarrë dhe për veprimet që planifikon t'i ndërmarrë KPK-ja, me qëllim që t'i përgjigjet OJQ-së "ADMOVERE" në pyetjet e drejtuara më 21 shkurt 2019.

Më 1 korrik 2019, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga KPK-ja, përmes së cilës është njoftuar se të dhënat statistikore që janë kërkuar nga OJQ "ADMOVERE" janë shumë specifike dhe sistemi prokurorial aktualisht e ka të pamundur t'i klasifikojë në atë formë në sistemin aktual të mbledhjes së statistikave. Më tej KPK-ja ka njoftuar se një kërkesë e tillë mund të realizohet vetëm pas futjes në funksion të sistemit SMIL. Këtë informacion KPK-ja ka thënë t'ia ketë dhënë edhe përfaqësuesve të OJQ "ADMOVERE" në takimet që janë mbajtur bashkërisht. Megjithatë, OJQ "ADMOVERE" nuk ka marrë përgjigje me shkrim nga KPK-ja.

Nga sa u tha më lart dhe në drejtim të trajtimit të kërkesës së OJQ "ADMOVERE", Avokati i Popullit thekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: *Kushtetuta*), në nenin 41, paragrafi 1, parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike: "*Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*" Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton: "*Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*" Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së: "*Ky ligj garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik.*"

Më tej Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së, ku sipas nenit 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. GjEDNj-ja, në aktgjykimin për rastin *Stell and Morris v The United Kingdom*, i datës 15 maj 2005, ndër të tjera, e konsideron se në një shoqëri demokratike edhe grupet e vogla dhe ato joformale duhet të jenë në gjendje t'i kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë efektive dhe se ekziston një interes i fortë publik që ua mundëson grupeve dhe individëve të jashtëm që të kontribuojnë në debatin publik, duke dhënë informacione me interes të përgjithshëm (paragrafi 89).²

Avokati i Popullit konsideron se interesi i informimit të publikut për mënyrën se si administrohen rastet nga sistemi i drejtësisë, ku të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar janë profesorët e Universitetit të Prishtinës, është thelbësor në drejtim të promovimit dhe të forcimit të demokracisë dhe të funksionimit të mirë të sistemit të drejtësisë. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë edhe shoqëria civile dhe mediat.

Nisur nga parimet themelore të së drejtës për qasje në dokumente publike, që dalin nga LQDP-ja (neni 4), përcaktohet se e drejta për qasje në dokumente publike e secilit person, garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente (paragrafi 1). Ndërsa neni 11 i LQDP-së përcakton: "*Kërkesat për qasje në dokumente publike, apo për ripërdorim të dokumenteve publike trajtohen me shpejtësi dhe sipas parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë sipas Ligjit përkatës për Procedurën e përgjithshme administrative.*"

² Rasti *Stell and Morris v The United Kingdom*, (Aplikimi nr. 68416/01, 15 maj 2005), paragraph 89.

Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se, në rastin konkret, KPK-ja është dashur të veprojë në pajtim me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, sipas të cilit përcaktohet se kërkuar ka të drejtë që, pas parashtrimit të kërkesës, të marrë aktvendim të arsyetuar me shkrim nga ai institucion publik, përkitazi me refuzimin dhe të nxjerrë aktvendim me të cilin tregohen arsyet e refuzimit për qasje në dokumente publike. Respektivisht, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, KPK-ja duhet të veprojë në përputhje me nenin 17, paragrafët 7 dhe 8, të këtij ligji.


Bazuar në gjithë këtë që u tha më sipër, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Këshillit Prokurorial të Kosovës

- *Ta shqyrtojë kërkesën e OJQ "ADMOVERE" për qasje në dokumente publike dhe t'i kthejë përgjigje në pajtim me Ligjin 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Kopje: Z. Lavdim Krasniqi, drejtor i Sekretariatit, Këshilli Prokurorial i Kosovës.